

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-234/2015

**Prishtinë,
3 Maj 2018**

Në çështjen juridike të:

B. J.

Pala ankuese

kundër

P. K.

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani, anëtarë të kolegjit, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/254/2014 të datës 27 gusht 2014 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA08960), pas këshillimit të mbajtur më 3 Maj 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga B.J. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/254/2014 të datës 27 gusht 2014, në lidhje me kërkesën e regjistruar në AKP me numër KPA08960.
2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/254/2014 i datës 27 gusht 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar pranë AKP me numrin KPA08960.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 8 shkurt 207, P. K. (tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (tani e tutje “AKP”) në emër të babit të tij T. K, duke kërkuar vërtetimin e pronësisë dhe ri-posedimin e ngastrës nr. 1398/2 e cila gjendet në ish rrugën “17 Nëntori”, komuna kadastrale Pejë me sipërfaqe prej 98 m² (tani e tutje: prona e kërkuar). Ai kërkon kthimin e posedimit të shtëpisë dhe dy lokaleve afariste me sipërfaqe të përgjithshme prej 294 m² duke deklaruar se prona e kërkuar është shkatërruar dhe në vend të saj është ndërtuar një objekt i përmasave shumë të mëdha. Ai kërkon kthimin e posedimit të ngastrës dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar.
2. Në kërkesë ka theksuar se pronën e kërkuar e ka humbur për shkak të konfliktit të armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në vitin 1998/99, duke e përmendur qershorin e vitit 1999 si datë të humbjes së pronës.
3. Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai i ka dorëzuar AKP-së dokumentet në vijim:
 - Kopjen e certifikatës së vdekjes të lëshuar nga libri amë i të vdekurve në Prizren me 18 shtator 1989 në të cilën shihet se babai i palës përgjegjëse në ankesë ka ndërruar jetë me 16 prill 1989;
 - Aktvendimin e trashëgimisë O.Br.935/07 i lëshuar nga Gjykata e parë Komonale në Beograd me të cilin pala përgjegjëse në ankesë dhe vëllai i tij I. trashëgonin pronën e kërkuar secili nga ½ pjesë ideale,
 - Fotografi të objektit të shkatërruar dhe të objektit të ndërtuar rishtas në pronën e kërkuar;
 - Venim i Komisionit të Kërkesave pronësore e Banesore HPCC/D/172/2005/C i datës 24 Shkurt 2005 me të cilin me urdhër deklarativ konstatohet se e ëma e palës përgjegjëse R. K. në ditën e shkatërrimit të pronës ka dëshmuar të drejtë pronësore mbi objektin e banimi dhe se i ka plotësuar kushtet për një urdhër për dëbim dhe kthim të posedimit. Ky vendim deklarativ i referohet bronës banesore.(Neni 1.2 i UNMIK/REG/1999/23 parasheh se “Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, Drejtoria për Çështje Pronësore e Banesore merr dhe regjistron kategoritë e

mëposhtme të kërkesave që kanë të bëjnë me pronën banesore, duke përfshirë këtu edhe pronën e shoqëruar me të dhe pas përpunimit ja referon Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore).

- Kopjen e ekstraktin të fletës poseduese të lëshuar nga Qendra për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e Komunës së Pejës (e dislokuar në Serbi) më 13 Janar 2007, në të cilën figuron se babai i ti si pronar i pronës së kërkuar,
4. Njoftimi fillestar i pronës së kërkuar është bërë më 28 maj 2010 duke publikuar njoftimin n gazetën nr. 1. Prona është vizituar me 27 Dhjetor 2012 dhe 21 Maj 2014 duke gjetur se prona ishte një teracë e një kafaneje dhe trotuar (rrugë kalimi për këmbësor) afër ndërtesës.
 5. B. J. (tani e tutje “pala ankuese”) ishte gjetur duke e shfrytëzuar pronën e kërkuar gjatë vizitës së pronës nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së me datën 21 Maj 2014. Ky i fundit kishte refuzuar të nënshkruaj njoftimin për pjesmarrje në procedurë. Me vonë J. kishte deklaruar se pretendon të drejtë ligjore mbi pronën e kërkuar duke deklaruar se e ka blerë të njëjtën nga B.S. (pala e tretë).
 6. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte verifikuar pozitivisht dokumentat e paraqitur nga pala përgjegjëse në ankesë siç shihet edhe nga raporti i verifikim i datës 16 korrik 2014. Për më tepër aktvendimi trashigimor i vitit 2007 ishte azhuruar dhe të dhënat kadastrale tregojnë se prona e kërkuar ishte tani e regjistruar si bashkëpronësi e palës përgjegjëse në ankesë dhe vëllait të tij me nga 1/2 e pjesëve ideale.
 7. Më 27 gusht 2014, KKPK- ja me vendimin e saj KPCC/D/R/254/2014 ka aprovuar kërkesën dhe ka gjetur se pala përgjegjëse në ankesë ka dëshmuar pronësinë mbi pronën e kërkuar dhe është pronar i 1/2 të tokës në të cilën ishte vendosur objekti dhe se i përmbush kriteret e kthimit të posedimit. Në paragrafët 23 dhe 25 të Vendimit të KKPK-së bazuar në provat e paraqitura nga pala përgjegjëse në ankesë dhe në mungesën të mbrojtjes së vlefshme nga ana e palës ankuese kërkesa miratohet. Pjesa e kërkesë për kompensim ishte hedhur për mungesë të Juridiksionit.
 8. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 25 Shkurt 2015. Me 27 Janar 2015 pala ankuese ka refuzuar të pranoi Vendimin e KKPK-së ndërsa me 29 Korrik 2015 ka paraqitur ankesë.
 9. Ankesa i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 7 Tetor 2015. Ai ka paraqitur përgjigje ndaj ankesës me 26 tetor 2015 dhe ka dorëzuar midis tjerash edhe cetifikatën e pronësisë të datës 8 Prill 2009 që dëshmon se prona e kërkuar tani evidentohet si bashkëpronësi 1/2 e pjesës ideale të palës përgjegjëse dhe vëllait të tij.
 10. Më datën 29 qershor 2015 Sekretaria e AKP-së i kishte dorëzuar Vendimin e KKPK-së edhe Kuvendit Komunal të Pejës por nuk ka pas reagim lidhur me vendimin e KKPK-së nga ana e Komunës së Pejës.
 11. Më 29 Qershor 2015 AKP-ja i kishte dorëzuar vendimin edhe shfrytëzuesit tjetër B.S. i cili nuk ka paraqitur ankesë në këtë vendim.

Pretendimet e palëve

12. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës ta hedhë poshtë kërkesën e palës përgjegjëse në ankesë për shkak se nuk përmban argumente të mjaftueshme dhe se ai është vetëm në shfrytëzim të një pjese të pronës së kërkuar.
13. Sipas mendimit të palës ankuese të gjitha faktet e paraqitura nuk janë vlerësuar në mënyrë të barabartë sepse gjatë procedurës është nxjerr një vendim që është i pazbatueshem.
14. Pala ankuese nuk ka paraqitur asnjë provë me të cilën dë të vënte në pyetje të drejtën ligjore të palës përgjegjëse në ankesë.
15. Në përgjigje të ankesës pala përgjegjëse në ankesë ka mbetur pranë pretendimeve si në shkllën e parë dhe ka kërkuar nga Gjykata që të refuzoi ankesën si pa meritë.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmeria e ankesës

16. Edhe pse pala ankuese nuk ka qenë vazhdimisht aktive gjatë procedurës në shkallën e parë dhe kishte refuzuar ta pranoi vendimin e KKKP-së dhe nënshkrimin e fletë dërgesës për pranimin e vendimit me 27 Janar 2015, ai paraqet ankesë me 29 Korrik 2015 gjë që në shikim të parë ankesa duket të jetë pasafatëshme sepse ishte paraqitur pas kalimit të 30 ditëve nga dita e tentim dorëzimit të parashikuar me dispozitën e nenit 12 par. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se *“ankesa kundër vendimit të KPCC mund të ankimohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit”*.
17. Në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi as të dorëzimit e as të refuzimit por në korespondencë me palën ankuese (shih faqe 169 të shkresave të lëndës) thuhet se ai ka refuzuar të pranoi vendimin e KKKP-së me arsyetim se Komuna e Pejës e shfrytëzon pronën e kërkuar si rrugë publike dhe ka sygjëruar që vendimi t'i dërgohet Komunës së Pejës.
18. Gjykata Supreme gjeti se ky dorëzim është në mosperputhje me dispoziata ligjore të Ligjit bazik dhe të Ligjit mbi procedurën kontestimore për këto arsye: Neni 6.3 në lidhje me nenin 6.5 (b) të Urdhëresës Administrative 2007/5 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 siç është ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 përcakton se: *“Sekretaria Ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronës sigurohet që dërgesa të bëhet në adresën për kryerjen e dërgesave të asaj pale, qoftë duke e dërguar kopjen e dokumentit përmes postës zyrtare, e cila jep vërtetimin, apo përmes dorëzimit personal të kopjes, për të cilin po ashtu merret vërtetimi për dorëzimin e dokumentit. Në rast të dërgimit personal të dokumentit, nëse pala pranuese ka refuzuar pranimin e dokumentit apo nënshkrimin e vërtetimit për praninë, në ditën kur shërbimi është tentuar të kryhet, personi që e dorëzon dokumentin e shënon se dokumenti nuk është pranuar dhe kthehet në Sekretarinë Ekzekutive”*.
19. Gjykata gjeti se Sekretaria e AKP-së ka dështuar të bëjë dorëzimin e rregulltë sepse mungon fletëdorëzimi dhe se zyrtari i Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së nuk ka shënuar se pala ankuese e ka pranuar vendimin e KKKP-së apo ka refuzuar që ta nënshkruaj dëshminë. Mbi këtë bazë dhe bazuar në sqarimet e mësipërme Gjykata Supreme konsideron se dorëzimi me 27 Janar 2015 nuk ka qenë i ligjshëm bazuar në përcaktimet të nenit 112 të të Ligjit nr.

03/L006 mbi procedurën kontestimore që parashihet se “Kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtari i rritur i familjes së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuar në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, **dorëzuesi do t’ia lejë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi i tillë apo do t’ia bashkëngjis shkresën në derën e banesës apo lokalit të punës. Në fletë dërgesë do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa.** Nëse përmbushën kushtet “komunikimi i kryer në këtë mënyrë qubet i ligjshëm”.

20. Gjykat Supreme e konsideroi si të afatshme ankesën, megjithatë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve, provave të mbledhura në shkresat e lëndës dhe vendimit të atakuar, konsideron se ankesa është e pabazuar.
21. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë të gjykojë kërkesat që kanë të bëjnë me konfliktin duke përfshirë rrethanat që lidhen drejtpërdrejt ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Prandaj, pala pretenduese jo vetëm që duhet ta sigurojë të drejtën e pronësisë mbi një pronë të paluajtshëm private, por edhe duhet të tregojë se ai apo ajo tani nuk ka mundësi ta ushtrojë atë të drejtë pronësore për arsye që lidhen drejtpërdrejt ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur.
22. Pala përgjegjëse në ankesë ka deklaruar se e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar më 12 qershor 1999 si rezultat i rrethanave të vitit 1998/1999 në Kosovë.
23. Në anën tjetër, pala ankuese pretendon se Vendimi i KKPK-së është i nxjerrë mi shkelje dhe pasaktësi se ai nuk e shfrytëzon pronën por vetëm një pjesë të saj si teracë për kafene (lokal hotelierik) dhe se këtë pjesë që e shfrytëzon e ka blerë nga një person tjetër i quajtur Bashkim Spahija. Asnjëra nga palët e treta nuk e kanë kontestuar vendimin e KKPK-së përmes mundësisë së nderhyrjes apo bashkangjites së përgjigjes në kërkesë.
24. Provat e paraqitura para KKPK-së tregojnë se babai i palës përgjegjëse në ankesë ka qenë pronar i evidentuar në kadastër deri në vitin 2007 kur mbi bazën e vendimit të Trashigimisë është bërë azhurimi dhe ndryshimi kadastral ku pala përgjegjëse dhe vëllai i tij ishin regjistruar si pronar. Kjo dëshmohet edhe me certifikatën e pronësisë të datës 8 Prill 2009.
25. Në anën tjetër, duhet të shënohet se as në procedurën e shkallës së parë para KKPK-së e as në ankesë pala ankuese nuk ka paraqitur asnjë provë apo argument ligjor me të cilin do të kontestonte të drejtën pronësore të palës përgjegjëse në mënyrë valide. As pretendimi se prona është blerë nga pala e tretë nuk është dëshmuar me prova dhe nuk paraqet mbrojtje valide për palën ankuese në kundërshtim të kërkesës dhe në fazën e ankesës.
26. Gjykata Supreme konsideron se kërkesa është e lidhur drejtpërdrejtë me konfliktin e armatosur për arsye se pala përgjegjëse në ankesë ka konfirmuar se humbja e pronës së kërkuar ka ngjarë për shkak të konfliktit të armatosur, kurse pala ankuese nuk e ka vërtetuar të kundërtën sepse nuk ka dëshmuar se e ka pas në posedim para dhe gjatë konfliktit. Përveç kësaj, pala ankuese ka deklaruar se vetëm e shfrytëzon si teracë të kafenese dhe nuk ka paraqitur asnjë dokument për transaksion eventual me pronarin apo personat e tretë siq pretendon.

27. Sa i përket kërkesës së palës përgjegjëse në ankesë për kompensim e dëmit me shkatërrimin e pronës dhe kompensimi për dëmin e shkaktuar , sipas ligjit nr. 03/L-079 as Komisioni e as Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme nuk kanë juridiksion mbi një kërkesë të tillë.
28. Gjykata Supreme gjen se KKKP-ja ka marrë vendim të drejtë, të bazuar në procedurë të plotë dhe të saktë. Rrjedhimisht nuk është bërë asnjë shkelje e ligjit material si dhe nuk është bërë vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike. Gjykata Supreme gjenë se ankesa është e pabazuar dhe se vendimi i apeluar duhet të konfirmohet.
29. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në bazë të nenit 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami , kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it

Ragip Namani , gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, referente e EULEX-it